



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:283579

Datë: 03.03.2023

Numri i dokumentit: 04044067

PKR Nr. 23/23

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti i Krimeve të Rënda**, Kryetari i Trupit gjykues Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Alan Taranish, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë të mbajtur me dt. 24.02.2023, në çështjen penale kundër të pandehurit D. Z. nga P., për shkak të kryerjes së veprave penale “Falsifikim i parasë”, nga neni 296 par. 2, të KPRK-së dhe “Mashtrimi” nga neni 323 par. 1 të KPRK-së, në praninë e Prokurorit të Shtetit Ersan Qavolli, të pandehurit D. Z. si dhe mbrojtëses së tij av. Aurora Mulhaxha, e caktuar sipas autorizimit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 03.03.2023, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri:**

**D. Z.**, i lindur me dt. ... në P., ku edhe banon në Rr. “W...” nr. , lagjja K., i biri i R. dhe nënës Z. e vajzërisë N., me profesion kuzhinier, i pa martuar, posedues i nr. tel. 049/...-..., i identifikuar në bazë të numrit personal ..., i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i R. Kosovës, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak së:**

**I.** Me datë 15.09.2022 rreth orës 19:20 në D. rr. “L.H.”, me dije e vë qarkullim paranë e falsifikuar duke e ditur se është e tillë, në atë mënyrë që, i pandehuri D. shkon në marketin “L. – Z”, në D. dhe pasi i blenë dy pako me cigare bënë pagesën me kartëmonedhën në vlerë prej 100€ me numër serik ..., e cila kartëmonedhë pas ekzaminimit ka rezultuar të jetë e falsifikuar, gjersa punëtorja e marketit i kthen si kusur 94.90€.

- Me çka ka kryer vepër penale **“Falsifikim i parasë”**, nga neni 296 par. 2, të KPRK-së.

**II.** Me dt. 15.09.2022, rreth orës 19:20 në D., Rr. “L. H.”, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, me anë të paraqitjes së rreme të fakteve, mashtron personin tjetër dhe me këtë e nxitë atë që të veproj në dëm të pasurisë së tij dhe atë të dëmtuarën

S. K., në atë mënyrë që, i pandehuri D. pasi siguron kartëmonedhën në vlerë prej 100€, me numër serik X2..., e cila kartëmonedhë pas ekzaminimit ka rezultuar të jetë e falsifikuar, shkon në marketin “L. – Z”, në D., i blenë dy pako me cigare dhe rrejtshëm i prezanton shitëses së marketit, S. K. se të njëjtat janë original e cila e merr atë dhe i kthen kusur 94.90€.

- Me çka ka kryer vepër penale “**Mashtrimi**” nga neni 323 par. 1, të KPRK-së.

Andaj, në aplikim të nenit 7, 8 par. 1, 17, 21, 38, 39 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.2, 40 par. 1 nën par. 1.3, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69 par.1 pika 3.6 dhe 3.7, 70, 71, 72, 296 par. 2 dhe par. 6, 323 par. 1 të KPRK-së, si dhe neni, 361, 364, 365, 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6, 457 dhe 462 dhe po ashtu neni 230 të KPRK-së, në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë nën shenjen PP/I Nr. 322/22 të dt. 16.01.2023 të akuzuarit i:

## P Ë R C A K T O N

- Për veprën penale “Falsifikim i parasë” nga neni 296 par. 2, të KPRK-së dënim me burgim në kohëzgjatje prej dhjete (10) muajsh, me kusht për një (1) vit.
- Për veprën penale “Mashtrimi” nga neni 323 par. 1 të KPRK-së, dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muajsh, me kusht për një (1) vit, dhe dënim me gjobë në shumë prej treqind (300) euro, e të cilën gjobe i njëjti obligohet ta paguaje në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

**Konform neni 76 par. 1 dhe 2, pika 2.2 të KPRK-së, gjykata të pandehurit i:**

## S H Q I P T O N

- I. Dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej një (1) viti, e i cili dënim fare nuk ka për tu ekzekutuar nëse i njëjti në afat prej dy (2) vitesh, nuk kryen vepër tjetër penale.
- II. Si dhe dënim me gjobë në shume prej treqind (300) euro, e të cilën gjobe i njëjti obligohet ta paguaje në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- I. Nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit kryen vepër tjetër penale, dënimi i kushtëzuar prej një (1) viti, do të revokohet dhe do të zëvendësohet në burgim efektiv.
- III. Nëse i pandehuri refuzon, dështon apo nuk dëshiron ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë ky dënim do te zëvendësohet me dënim burgimi, duke i llogaritur shumen prej njëzete (20) euro, për një (1) ditë burgimi.
- IV. Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro si dhe shumen prej 50

(pesëdhjete) euro për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- V. Në kuptim të nenit 296 par. 6, të KPRK-së, të pandehurit D. Z. i **KONFISKOHET** një (1) kartëmonedhe prej një qind (100) euro me numër serik X...
- VI. Në kuptim të nenit 61 të KPRK-së e lidhur me nenin 230 par. 8 të KPPRK-së, **URDHËROHET** i pandehuri D. Z. që të dëmtuarës S. K. t'ia kompensoj demin e shkaktuar në vlerë prej një qind (100) euro.

### Arsyetim

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, me datën 04.02.2023 ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/I Nr. 322/22 kundër të pandehurit D. Z. nga Peja, për shkak të veprave penale “Falsifikim i parasë” nga neni 296 par. 2, të KPRK-së dhe “Mashtrimi” nga neni 323 par. 1 të KPRK-së.

Se bashku me aktakuzën, prokuroria i ka dërguar gjykatës njoftimin për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, e lidhur në mes Prokurorisë, të dëmtuarës S. K., të pandehurit D. Z. dhe mbrojtëses së tij, av. Aurora Mullhaxha, si dhe marrëveshjen e arritur me dt. 23.01.2023.

Gjykata me datën 24.02.2023, ka caktuar dhe mbajtur seancën për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ku prezent kane qene Prokurori i Shtetit Ersan Qavolli, i pandehuri D. Z. si dhe mbrojtësja e tij av. Aurora Mullhaxha e angazhuar sipas autorizimit.

Në kuptim të nenit 230 par. 17, të KPPRK-së, kryetari i trupit gjykues ka dëgjuar të pandehurin dhe ka vërtetuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën e veprës penale e cila i është vënë në barrë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, se nuk ka qenë i detyruar apo shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranoj fajësinë, se pranimi i fajësisë ka mbështetje në fakte dhe prova materiale të paraqitura në aktakuzë dhe se nuk ekziston asnjë rrethanë për hedhje të akuzës që parashihet me nenin 248 par.1, të KPPRK-së.

Në kuptim të nenit 230 par.18 të KPPRK-së, kryetari i trupit gjykues ka dëgjuar pikëpamjet të Prokurorit të Shtetit, të pandehurit dhe mbrojtëses së tij.

Prokurori i Shtetit në lidhje me marrëveshjen për pranimin e fajësisë deklaroi se: *mbetem në tërësi pranë marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë nga ana e pandehurit e cila marrëveshje është arritur pas konsultimeve të mjaftueshme të tij me mbrojtësin e tij, duke i vënë në dijeni së pari veprat e kryera pastaj pasojat e veprave dhe dënueshmërinë e tyre.*

Po ashtu i pandehuri dhe mbrojtësja e tij kanë deklaruar se mbeten në tërësi pranë marrëveshjes së arritur për pranimin e fajësisë me Prokurorin e Shtetit.

Me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, e konform nenit 230 të KPPRK-së, gjykata fillimisht ka përcaktuar se i pandehuri ka kuptuar natyrën e veprës penale, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe se nuk ka qenë i detyruar apo shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë se pranimi i fajësisë ka mbështetje në fakte dhe prova materiale të cilat paraqitën në aktakuzë dhe se nuk ekziston asnjë rrethanë e paraparë me nenin 248 par. 1, të KPPRK-së.

Gjykata është bindur se janë plotësuar kushtet nga neni 230 par. 17, i KPP-së, respektivisht se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, çka e pohoi edhe vet i pandehuri dhe mbrojtësja e tij gjatë seancës, së pranimit i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij, dhe se nuk ka qenë i shtrënguar apo i detyruar në asnjë mënyrë që ta pranoje fajësinë, gjë që po ashtu është pohuar nga i pandehuri dhe mbrojtësja e tij, tutje gjykata gjeti së ky pranim i fajësisë ka mbështetje edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, siç janë: *Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë dt. 23.01.2023; Raporti i oficerit D. G. KPS... dt. 16.09.2022; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve dt. 16.09.2022; Shënimi zyrtar nga J. J. #... dt. 16.09.2022; Shënimi zyrtar nga J. J. # dhe Xh. N. #... dt. 17.09.2022; Fotografitë nga shkresat e lëndës; Raporti i shpejtë dt. 17.09.2022; USB-ja, në të cilën janë video incizimet e kamerave të sigurisë; dhe Raporti i ekspertimit AKF/2022-.../22-... dt.14.10.2022*, dhe se nuk ekziston asnjë rrethane tjetër e paraparë me nenin 248 par. 1, të KPPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 230 par. 20, të KPPRK-së, ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe në pajtim me marrëveshjen, dhe ka urdhëruar që kjo marrëveshje të vendoset në shkresat e lëndës në gjykatë.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata për të pandehurin, mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në pajtim me nenin 69 par.1, të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese mori sjelljen e tij korrekte në gjykatë gjatë shqyrtimit, i njëjti ka pohuar se ndjen keqardhje, faktin se është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, si dhe pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes dhe faktin se i njëjti me parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë veprë tjetër penale, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikojë edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë, që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-se.

Vendimi për shqiptimin e dënimit me burgim me kusht për veprën penale “Falsifikim i parasë” u morr konform nenit 46,47,48,49, e lidhur me nenin 296 par. 2 të KPRK-së.

Vendimi për shqiptimin e dënimit me burgim me kusht dhe me gjobë për veprën penale “Mashtrimi” u morr konform nenit 43 dhe neneve 46,47,48,49, e lidhur me nenin 323 par. 1, të KPRK-së.

Vendimi për shqiptimin e dënimit unik të kushtëzuar me burgim u morr konform nenit 76 par. 1 dhe 2 nën par. 2.2 të KPRK-së.

Vendimi për shqiptimin e dënimit me gjobë u morr konform dispozitës së nenit 43 e lidhur me nenin 323 të KPRK-së.

Vendimin mbi zëvendësimin e dënimit me kusht në dënim burgimi në rast se i pandehuri brenda periudhës së verifikimit kryen veprë tjetër penale u morr në përputhje me nenin 50 par. 1 dhe 2 të KPRK-së.

Vendimi për zëvendësimin e dënimit me gjobë në dënim burgimi në rast se i pandehuri nuk e paguan, dështon apo refuzon ta paguaje dënimin e shqiptuar me gjobë u marr konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u marr në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi për taksat e kompensimit të viktimave të krimit, u marr në bazë të qarkores për zbatimin e ligjit NR.05/L-36.

Vendimi për konfiskimin e kartëmonedhës së falsifikuar u marr në përputhje me nenin 296 par. 6 të KPRK-së.

Në kuptim të nenit 61 të KPRK-së e lidhur me nenin 230 par. 8 të KPPRK-së, i pandehuri është urdhëruar që të dëmtuarës t'ia kompenson dëmin e shkaktuar me kryerjen e veprës penale.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA**  
**PKR NR. 23/23 dt. 03.03.2023**

**Zyrtari ligjor**  
Alan Taranish

**Kryetari i trupit gjykues,**  
Murat Hulaj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.